



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 966/ 12 prot.

Datë 17/05/2024

V E N D I M
Nr. 524/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17/05/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 475/2024, datë 09.05.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge”, me fond limit: 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “KALIA” SHPK me Nipt L41320036L me adresë: Rruga “Hoxha Tasim”, Vila “Kalia”, Kati i dytë Paskuqan, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr.492, Kamëz.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren: I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 475/2024, datë 06.03.2024, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KALIA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge”, me fond limit 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.*
2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “KALIA” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër..*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dajeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *garkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KALIA” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 368 prot., datë 14.05.2024, protokolluar me tonën nr. 966/9 prot., datë 16.05.2024, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 475/2024, datë 09.05.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke i rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “KALIA” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge”, me fond limit 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 368 prot., datë 14.05.2024, protokolluar me tonën nr. 966/9 prot., datë 16.05.2024, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 475/2024, datë 09.05.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke i rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “KALIA” Sh.P.K në procedurën e

prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “*Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge*”, me fond limit 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka rishikuar arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorit ekonomik “KALIA” Sh.P.K në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 475/2024, datë 09.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “*Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge*”, me fond limit 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

